

Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”

Dega e Gjuhës dhe Letërsisë angleze

Lënda: Gjuhë e sotme shqipe 1

Lëndë e obliguar. Niveli bachelor

Viti I i studimeve. Semestri I

Numri i orëve në javë: 2 + 2

Kodi ose shifra e lëndës:

Vlera në kredi ECTS: 6

Mësimdhënësja e kursit: Prof.Ass. Dr. Flutura Çitaku

Qëllimet e kursit: Përvetësimi i njohurive rreth strukturës gramatikore të gjuhës shqipe .

Rezultatet e pritura të nxënies:

Pas përfundimit të këtij kursi studentët do të jenë në gjendje:

- Të flasin dhe të shkruajnë rrjedhshëm gjuhën standarde shqipe.
- Do të aftësohen për të bërë punë të suksesshme në procesin e mësimdhënies së gjuhës angleze, duke fituar paraprakisht njohuri të mjaftueshme nga kursi i gjuhës së sotme shqipe. Këto njohuri do t’u hyjnë në punë për të bërë krahasime midis strukturës së dy gjuhëve.
- Do të aftësohen për të bërë përkthime të mira nga gjuhët që studiojnë në gjuhën shqipe dhe anasjelltas

Metodologjia e mësimdhënies: Ligjërata, ushtrime, diskutime, punime seminari, detyra shtëpie, hartimi i një fjalorthi bashkë me studentët me titull: “Fjala shqipe në vend të fjalës së huaj”, ku do të përfshihen fjalët e huaja të panevojshme që po përdoren sot kudo. Përballë këtyre fjalëve do të jepen gjegjëset e tyre në shqip. Puna rreth këtij fjalorthi do të vazhdojë gjatë tërë semestrit dhe do të jetë detyrë e përhershme e studentëve për të sjellë sa më shumë fjalë.

Plani i detajuar i mësimit

Java e parë:

- Njohuri të përgjithshme për morfologjinë
- Objekti i morfologjisë dhe lidhjet e morfologjisë me disiplinat e tjera
- Kuptimet gramatikore dhe format gramatikore
- Pjesët e ligjëratës

Literatura: Ali Jashari, Flutura Çitaku, Morfologjia e zbatuar, Prishtinë, 2014, f. 9-16

Java e dytë:

- Struktura morfologjike e fjalës dhe tipat e fjalëformimit
- Fjala dhe morfema
- Llojet e morfemave
- Temat e fjalës

- Analiza morfemore dhe analiza fjalëformuese
- Fjalë të parme dhe fjalë jo të parme
- Mënyrat e formimit të fjalëve në gjuhën shqipe

Literatura: Ali Jashari, Flutura Çitaku, Morfologjia e zbatuar, Prishtinë, 2014, f.17-35

Java e tretë:

- Emri
- Njohuri të përgjithshme
- Grupet leksiko-gramatikore të emrave
- Kategoria gramatikore e gjinisë
- Kategoria gramatikore e numrit

Literatura:Ali Jashari, Flutura Çitaku, Morfologjia..., Prishtinë, 2014, f. 36-41

Java e katërt:

- Kategoria gramatikore e rasës
- Kategoria gramatikore e shquarsisë dhe e pashquarsisë
- Tipat e lakimit
- Formimi i emrave

Literatura: Ali Jashari, Flutura Çitaku, Morfologjia..., Prishtinë, 2014, f.41-61

Java e pestë:

- Mbiemri
- Njohuri të përgjithshme
- Klasifikimi i mbiemrave
- Kategoritë gramatikore të mbiemrit
- Gjinia
- Numri
- Lakimi i mbiemrit
- Shkallët e mbiemrit
- Formimi i mbiemrave

Literatura: Ali Jashari, Flutura Çitaku, Morfologjia..., Prishtinë, 2014, f.62-79

Java e gjashtë:

- Numërori
- Njohuri të përgjithshme
- Numërorët themelorë
- Veçoritë strukturore e morfologjike të numërorëve themelorë
- Thyesat

Literatura: Ali Jashari, Flutura Çitaku, Morfologjia..., Prishtinë, 2014, f. 80-86

Java e shtatë:

- Përemri
- Njohuri të përgjithshme për përemrat
- Klasifikimi i përemrave
- Përemrat vetorë
- Lakimi i përemrave vetorë
- Trajtat e shkurtra dhe trajtat e shkurtra të bashkuara
- Vendi dhe përdorimi i trajtave të shkurtra
- Përemri vetvetor

Literatura: Ali Jashari, Flutura Çitaku, Morfologjia..., Prishtinë, 2014, f. 87-90

Java e tetë:

- Përemrat dëftorë
- Përemrat pronorë
- Përemrat pyetës
- Përemrat lidhorë
- Përemrat e pacaktuar
- Rreth përdorimit të përemrave gjatë ligjërimit

Literatura: Ali Jashari, Flutura Çitaku, Morfologjia..., Prishtinë, 2014, f.91-114

Java e nëntë:

- Folja
- Njohuri të përgjithshme për foljen
- Klasifikimi i foljeve sipas funksionit dhe kuptimit
- Foljet ndihmëse
- Foljet gjysmëndihmëse
- Foljet kalimtare dhe jokalimtare

Literatura: Ali Jashari, Flutura Çitaku, Morfologjia..., Prishtinë, 2014, f. 115-118

Java e dhjetë:

- Kategoritë gramatikore të foljes-veta dhe numri
- Kategoria gramatikore e mënyrës
- Kategoria gramatikore e kohës
- Kategoria gramatikore e diatezës

Literatura: Ali Jashari, Flutura Çitaku, Morfologjia..., Prishtinë, 2014, f.118-117

Java e njëmbëdhjetë:

- Zgjedhimi i foljeve (ndarja në zgjedhime: I, II, III)
- Foljet e parregullta
- Format e pashtjelluara
- Zgjedhimi vepror
- Zgjedhimi jovepror
- Formimi i foljeve

Literatura: Ali Jashari, Flutura Çitaku, Morfologjia..., Prishtinë, 2014, f. 121-147

Java e dymbëdhjetë:

- Ndajfolja
- Njohuri të përgjithshme për ndajfoljet
- Klasifikimi i ndajfoljeve sipas kuptimit
- Shkallët e ndajfoljeve
- Formimi i ndajfoljeve

Literatura: Ali Jashari, Flutura Çitaku, Morfologjia..., Prishtinë, 2014, f.148-157

Java e trembëdhjetë:

- Parafjala
- Njohuri të përgjithshme për parafjalët
- Klasifikimi i parafjalëve sipas prejardhjes dhe strukturës morfologjike
- Klasifikimi i parafjalëve sipas kriterit sintaksor dhe kuptimet kryesore të tyre

- Përdorimi i parafjalëve gjatë ligjëimit

Literatura: Ali Jashari, Flutura Çitaku, Morfologjia..., Prishtinë, 2014, f.158-165

Java e katërbëdhjetë:

- Lidhëzat
- Njohuri të përgjithshme për lidhëzat
- Klasifikimi i lidhëzave sipas prejardhjes
- Klasifikimi i lidhëzave sipas funksionit sintaksor

Literatura: Ali Jashari, Flutura Çitaku, Morfologjia..., Prishtinë, 2014, f.166-173

Java e pesëmbëdhjetë:

- Pjesëzat dhe pasthirrat
- Njohuri të përgjithshme për pjesëzat
- Vendi dhe theksimi i pjesëzave
- Klasifikimi i pjesëzave sipas strukturës dhe fjalëformimit
- Klasifikimi i pjesëzave sipas domethënies
- Pasthirrat dhe klasifikimi i tyre sipas prejardhjes dhe domethënies
- Tingullimitimet (onomatopetë)

Literatura: Ali Jashari, Flutura Çitaku, Morfologjia..., Prishtinë, 2014, f.174-192

- Vlerësimi i parë intermediar (test provues)- java e tetë
- Vlerësimi i dytë intermediar (test provues)-java e pesëmbëdhjetë

Shënim: Të dy testet provuese do të mbahen jashtë orarit të mësimi

Vlerësimi:

Vlerësimi i parë: 15%

Vlerësimi i dytë: 15 %

Detyrat dhe punimet e seminareve: 10 %

Vijimi i rregullt: 5 %

Provimi final 55 %

Gjithsej: 100 %

Provimi mbahet me test dhe plotësohet edhe me gojë.

Literatura bazë: Ali Jashari, Flutura Çitaku, Morfologjia e zbatuar, Prishtinë, 2014

Literatura plotësuese:

- ASHRSH, Gramatika e gjuhës shqipe, I, Tiranë, 2002
- Bahri Beci, Gramatika e gjuhës shqipe për të gjithë, EDFA, Tiranë, 2004
- Bahri Beci, Gramatika e gjuhës shqipe (për mësimdhënësit e gjuhës shqipe) Prishtinë, 1998;
- M. Çeliku, M. Karapinjolli, R. Stringa: Gramatika praktike e gjuhës shqipe, Tiranë, 2004
- Mehmet Çeliku, Çështje të shqipes letrare, Tiranë, 2001.

- ASHRSH; Për pastërtinë e gjuhës shqipe, Tiranë, 1998.
- Gjovalin Shkurtaç, Si të shkruajmë shqip, Tiranë , 2008
- IAP, Drejtshkrimi i gjuhës shqipe, Prishtinë, 1974
- ASHRSH, Fjalori drejtshkrimor i gjuhës shqipe, Tiranë, 1976
- Fjalorë të gjuhës shqipe (1980, 1984, 2002, 2006)
- Revistat: Studime filologjike dhe Gjuha jonë (Tiranë);Gjurmime albanologjike, Gjuha shqipe, Filologji (Prishtinë), etj.
- Z. Kadriu- L. Latifi, Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe (tekst ushtrimesh), Tetovë, 2008
- Vepra letrare, fragmentet e të cilave do të përdoren për ushtrime
- Të dhëna nga interneti